

REZULTATET E SONDAZHIT



Leendert van Driel, Banka Botërore
Tiranë, 8 Tetor, 2015

Axhenda

1. Hyrje
2. Pensionet private në situatën aktuale
3. Informacione në lidhje me kompanitë pjesëmarrëse
4. Ofrimi i planeve private të pensionit
5. Informacione për besimin në institucionet financiare
6. Konkluzione dhe rekomandime

Hyrje(1)

Në muajin qershor të vitit 2015 AMF-ja, në bashkëpunim me Institutin Shqiptar të Statistikave, ndërmorrën një sondazh për të studiuar nivelin e njohurive të punëdhënësve dhe të punëmarrësve dhe qëndrimin në lidhje me pensionet private.

Rezultatet e sondazhit kanë për qëllim që të japin input për zhvillimin e një strategjie për përhapjen e mbulimit të pensioneve private në Shqipëri.

Përhapja e mbulimit është një element thelbësor për qëndrueshmërinë financiare afatgjatë të sektorit të pensioneve private.

Sondazhi u fokusua në kompanitë që punësojnë një staf prej të paktën 20 vetash.

Kompanitë që financohen me kapital shtetëror u përjashtuan nga sondazhi.

Në sondazh morën pjesë 2,074 kompani, të cilat punësojnë 174,903 punonjës, 16.8 % të totalit të fuqisë punëtore të punësuar në Shqipëri.

Bazuar në përmasat e sondazhit, rezultati i sondazhit mund të konsiderohet si përfaqësues për situatën në Shqipëri





Hyrje (2)

Pyetjet në sondazh ishin grupuar në katër seksione:

1. *Pyetje në lidhje me informacione të përgjithshme për kompanitë përfshirë të dhënat nëse këto kompani ofrojnë plane pensioni për punonjësit e tyre*
2. *Pyetje për të marrë informacione nga kompani të cilat nuk ofrojnë plane pensioni për punonjësit e tyre*
3. *Pyetje për të marrë informacion nga kompani të cilat ofrojnë plane pensioni për punonjësit e tyre*
4. *Pyetje për të marrë disa informacione shtesë nga kompanitë pjesëmarrëse*

Situata aktuale (1)

Pensionet private ofrohen nga 3 Kompani që Menaxhojnë Pensionet: Raiffeisen, Sicred, Sigal. Pjesët e tyre në treg janë:



Për mbulimin, më e përshtatshme është përqindja në treg e anëtarëve.

Situata aktuale (2)

Analiza e të dhënave për mbulimin në Shqipëri të çon në konkluzionet që vijojnë:

- *Numri i njerëzve në Shqipëri me pensione vullnetare është shumë i vogël: në fund të vitit 2013 numri i anëtarëve me KMP është 3,1% e numrit të përgjithshëm të punonjësve që punojnë në kompanitë jo-bujqësore në Shqipëri*
- *Rritja e numrit të anëtarëve është e vogël duke marrë në konsideratë përmasat e tregut*
- *Sigal është KMP-ja më e madhe me afërsisht 50% të tregut*
- *Raiffeisen ka treguar një rritje shumë të vogël gjatë vitit 2014*

Informacione për kompanitë pjesëmarrëse (1)


Vetëm 22 (ose 1.06 %) e kompanive pjesëmarrëse në sondazh ofrojnë plane pensioni për punonjësit e tyre.

2,074 kompanitë pjesëmarrëse në sondazh janë kategorizuar në përputhje me kriteret në vijim:

- *Numri i punonjësve*
- *Aktiviteti ekonomik*
- *Pronësia*
- *Viti i themelimit*
- *Vendndodhja gjeografike*


Informacione për kompanitë pjesëmarrëse (2)

% e shpërndarjes së numrit të kompanive në çdo segment




Informacione për kompanitë pjesëmarrëse (3)

Përqindja e kompanive e renditur sipas vitit të themelimit



Informacion për kompanitë pjesëmarrëse (4)

Përqindja e kompanive pjesëmarrëse në vendndodhje gjeografike



Më shumë se gjysma e kompanive të anketuara janë të lokalizuara në rajonin e Tiranës

Informacione për kompanitë pjesëmarrëse (5)

Sondazhi zbuloi se ka një mungesë të rëndësishme të njohurive dhe të ndërgjegjësimit për sistemin Shqiptar të pensioneve dhe për pensionet vullnetare e pensionet që kategorizohen sipas profesionit si nga punëdhënësit edhe nga punëmarrësit

Kategoria e njohurive	Vlera e indeksit
Njohuritë e punëdhënësve për sistemin Shqiptar të pensioneve	1.64
Njohuritë e punonjësve për sistemin Shqiptar të pensioneve	0.91
Njohuritë e punëdhënësve për pensionet vullnetare dhe sipas profesionit	1.60
Njohuritë e punonjësve për pensionet vullnetare dhe sipas profesionit	0.91

Tabela rendit rezultatet në indeksin e njohurive, me 0 që i korrespondon “*Nuk ka njohuri*” dhe me 4 që i korrespondon “*Njohuri shumë të mira*”. Rezultati tregon se niveli i njohurive për të dyja grupet është poshtë nivelit mesatar prej 2, por është më i lartë tek punëdhënësit sesa tek punëmarrësit.

Informacione për kompanitë pjesëmarrëse (6)

Ofrimi i planeve të pensionit në Shqipëri është i kufizuar. Vetëm 14,1 % e Kompanive të anketuara janë kontaktuar nga një KMP. Pjesa tjetër prej 85,9 % nuk janë kontaktuar asnjëherë.

Një vështrim i përgjithshëm i KMP-ve të cilat kanë kontaktuar kompanitë për pensionet

- 45,1% e kompanive të kontaktuara janë kontaktuar nga Sigal
- 39,9 % e kompanive të kontaktuara janë kontaktuar nga SiCRED
- 15 % e kompanive të kontaktuara janë kontaktuar nga Raiffeisen



Dispozita e planeve të pensionit (1)

Pjesa më e madhe (98.9%) e kompanive të anketuara nuk ofrojnë plane pensionesh private.

Nga ky grup vetëm 14% e kanë marrë në konsideratë zhvillimin e një plani të pensionit profesional.

Këto janë përqëndruar në “Shërbime financiare dhe sigurimesh”, “Aktivitete shëndetësore dhe pune sociale” dhe në sektorët “Bujqësi, pylltari, peshkim”.

Arsyet kryesore për mos-prezantimin e planeve të pensioneve private jepen në tabelën më poshtë:

% e totalit	Përshkrimi
46	Mungesa e lehtësive financiare
43	Përparësia e dhënë në përfitime të tjera për punonjësit
36	Zhvillimi i planeve të pensionit është konsideruar me shumë kosto nga punëdhënësit

Një faktor tjetër i rëndësishëm për mos-prezantimin e planeve të pensioneve private ishte mungesa e besimit në sistemin financiar dhe KMP-të.

Dispozita e planeve të pensionit (2)

Sondazhi tregon se punonjësit kanë treguar pak interes për skemat e pensioneve.

Sipas kompanive, metodat më efikase për të rritur interesin e punonjësve për pensionet janë:

- *informacion më i mirë në formën e shkruar*
- *prezantimi sesi funksionon skema e pensionit*
- *shpjegimi i përfitimeve të skemave të pensionit tek punonjësit*
- *rritja e ndërgjegjësimit për pamjaftueshmërinë e skemës shtetërore*
- *nxitja e besimit për KMP-të dhe për sistemin financiar në përgjithësi*

Kjo tregon nevojën për zhvillimin e marketingut dhe të fushatave ndërgjegjëse dhe pro-aktivitetin e KMP-ve.

Dispozita e planeve të pensionit (3)

Vetëm 22 nga kompanitë e anketuara ofrojnë plane pensioni. Ato punësojnë 2.303 persona ose 1,3% të personelit total të kompanive të anketuara.

Grupi i kompanive që ofrojnë plane pensioni është përqëndruar në 2 zona të aktivitetit ekonomik, përkatësisht në fushën administrative e të shërbimeve mbështetëse dhe në fushën financiare e të shërbimeve siguruese.

Këto kompani janë përqëndruar në rajonin e Tiranës dhe janë konsideruar të mëdha sepse ato punësojnë 50 deri 249 persona.


Nga 22 kompanitë e anketuara të cilat ofrojnë plane pensioni, vetëm 8 kompani i ofrojnë këto plane për të gjithë personelin.

Në të gjitha rastet, kontributet e pensioneve janë në një raport 1 me 1 ndërmjet punonjësit dhe punëdhënësit.

Në 20 rastet punonjësit mund të zgjedhin që të kontribuojnë me një shumë më të madhe sesa është rënë dakord pa kontribut shtesë nga punëdhënësi.

Informacion për besimin në institucionet financiare

Besimi në sektorin financiar luan një rol të rëndësishëm në zgjerimin dhe në qëndrueshmërinë e sektorit. Marrëdhëniet financiare janë marrëdhënie besimi dhe pa këtë element, tregjet financiare nuk mund të zhvillohen, duke përfshirë tregun e pensioneve private.



Besimi në institucione, i specifikuar në tabelën më sipër është vlerësuar nën nivelin mesatar. Në një shkallë prej 5 pikësh, vlera e indeksit do të variojë midis 1,86 deri në 2,25.

Konkluzione dhe rekomandime

Bazuar në rezultatet e sondazhit, mund të nxirren konkluzionet e mëposhtme:

- *niveli i njohurive për pensionet private, si nga punëdhënësit edhe nga punonjësit, është shumë i kufizuar*
- *besimi në sistemin financiar është i dobët*
- *klima e biznesit dhe faktorët e kostos janë elementë të rëndësishëm në kufizimin e kërkesës për produkte të pensioneve private*
- *faktorët fiskalë, veçanërisht deri në vitin 2014, e kanë penguar zhvillimin e tregut të pensioneve*
- *ofrimi i pensioneve private ka qenë shumë i kufizuar deri tani*

Konkluzione dhe rekomandime

Dinamika e mplakjes e cila sjell risqe për qëndrueshmërinë e sistemit të pensioneve do të vazhdojë në Shqipëri.

Makro faktorët kryesorë që kanë shkaktuar zhvillimin e kufizuar të tregut pensioneve për një periudhë afatmesme duket se kanë mbetur të pandryshuar .

Kjo shpie në rekomandimet që vijojnë:

- *Në lidhje me ofruesit, ekziston nevoja për fushata marketingu më shumë agresive dhe për kontakte në rritje me kompanitë*
- *Në lidhje me kërkesën, përmirësimi i trajtimit fiskal të produkteve të pensioneve do të stimulojë kërkesën*
- *Duhet të ndërmerren hapa për të rritur ndërgjegjësimin publik për sigurinë dhe përfitimet e punonjësve individualë për kursimet e pensioneve*
- *Për afate më të gjata, konsiderata në rritje duhet t'i jepen hapave për të inkurajuar një pjesëmarrje më të madhe si pjesë e strategjisë së zgjerimit të zhvillimit të mbulimit*
- *Idetë e nxjerra në raport nga Raporti i Vlerësimit të Sektorit Financiar, i cili duket se është ndër praktikatat më të mira ndërkombëtare për zgjerimin e pensioneve private.*



Ju falenderojmë
për vëmendjen

World Bank Group
Tirana
Albania

